

Dëshmor Mamasi (Mamai/Mamanti)



E mërkurë, 2 shtator 2020 – Shenjtori i ditës

DITË KRESHME

Dëshmor Mamasi (Mamai/Mamanti). Oshënar Joan Kreshmuesi. Eleazari dhe Finesi, të Drejtë.

– Dëshmor Mamasi (Mamai/Mamanti) –

Shën Mamasi vinte nga Gangra e Panflagonisë (Azi e Vogël). Prindërit e tij Theodoti dhe Rufina ishin të krishterë. U zunë robër nga paganët dhe u burgosën, sepse nuk e mohuan Krishtin. Madje shenjtë u lind në burg, por prindërit i vdiqën atje, dhe fëmija i vogël u adoptua nga një grua e perëndishme me emrin Amiana (sipas të tjerëve Matrona). Qysh në belbëzimet e para nëna që e kishte adoptuar e thërriste Mamas.

Në moshën 15-vjeçare, u zu rob nga një grup perandorak, sepse kishte refuzuar të sakrifikoje para idhujve. E nxorën para Demokritit, qeveritarit të Qesarisë në Kapadoki, dhe më pas para perandorit Aurelian. Tirani u përpoq ta detyronte djaloshin, por shpirtin e Mamasit e gjeti më të fortë se diamanti dhe, për nga zelli hyjnor, më të zjarrtë se furra që kishin ndezur. Aureliani u zemërua dhe urdhëroi t'i bënin tortura nga më mizoret: rrahje, shkelma, goditje me shkopinj. Mendoj se vuajtja e kishte mundur Mamasin, dhe i tha: “Vetëm thuaj se ke sakrifikuar para

idhujve dhe kjo mjafton që të lirohesh”. Mamasi u përgjigj: “As zemra, as buzët nuk do ta mohojnë Zotin tim Jisu Krisht, o perandor; të falënderoj, se nëpërmjet këtyre vuajtjeve po më lejon të bashkohem më shumë me Mbretin tim, që hoqi për shpëtimin tim”. Ia dogjën trupin me pishtarë të ndezur dhe e goditën me gurë. I lidhën në qafë një gur dhe e hodhën në det. Shpëtoi për mrekulli nga një engjell i Perëndisë, me ndihmën e të cilit u gjend në një mal të qytetit të Qesarisë. Jetoj atje me lutje të pandërprerë dhe me falënderime. Shoqëri i bënin kafshët e egra, të cilat i jepnin qumështin e tyre si ushqim.

Pak kohë më pas, zbriti në qytet që t'i dorëzohej vetë qeveritarit të ri të Kapadokisë, Aleksandrit. Iu nënshtrua torturave. E hodhën në furrë të zjarrtë dhe ashtu si tre djemtë e Danielit në furrën e Babilonës, mbeti i paprekur duke himnuar Perëndinë. Përfundimisht, ushtarët ia shpuan brinjët me një sforc. Mamasi gjeti fuqi të dilte nga qyteti para se të jepte frymën e fundit. Dëgjoj një zë nga lart ta ftonte të vinte për t'u prehur në banesat qiellore.

* * * * *

- Eleazari dhe i biri, Fineesi, të Drejtë. -

Eleazari, djali i Aaronit, ishte përgjegjës për kujdesin e shenjtërores ku mbahej Arka e Besëlidhjes dhe të gjitha gjërat e nevojshme për sakrificat dhe shërbimin e urdhëruar nga Perëndia (Num. 4.16). Fineesi tregoi zellin e tij për Perëndinë kur vrau izraelitin që kishte kryer imoralitet me një nga vajzat e Moabit. Duke vepruar në këtë mënyrë, ai e ktheu zemërimin e Perëndisë, kështu atij dhe farës së tij, iu dha hiri i priftërisë së përhjetshme (Num. 25.13).

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë/facebook](#)